


DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE



DHOMA E BIZNESIT TË DIASPORËS SHQIPTARE MARRËVESHJE ME WORLD VISION ALBANIA

Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare ka firmosur një marrëveshje dypalëshe me World Vision Albania. Është kënaqësi për ne të bashkëpunojmë me World Vision Albania për mirërritjen dhe sigurinë e fëmijëve dhe familjeve shqiptare,”- tha Ardian Lekaj, Kryetar i Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare. Në më pak se një viti nga krijimi i saj Dhoma e Biznesit të Diasporës Shqiptare është angazhuar në çështje humanitare dhe sociale, duke mundësuar ndihma për familjet në nevojë pas tërmetit të 26 nëntorit, dhe gjithashtu duke mundësuar donacionine nga biznesmenë të Diasporës.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



SËRISH PROGRES NË LIRINË EKONOMIKE SHQIPËRIA NGJITET NË VENDIN E 26-TË NË BOTË

Instituti “Fraser” ka publikuar raportin e vitit 2020 për lirinë ekonomike, që është një prej raporteve më prestigjioze në nivel global në këtë drejtim. Sipas raportit të këtij viti, Shqipëria renditet në vendin e 26-të në botë, ndër 162 ekonomi, duke qenë një prej vendeve me performancën më të mirë në botë në këtë drejtim. Nga ana tjetër, renditja e këtij viti përkthehet në një përmirësim me 4 pozicione në renditjen globale, pasi një vit më parë renditej në vendin e 30-të në botë.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



“MARLOTEX” E SIPËRMARRËSIT GAZMEND TOSKA DHURON MASKA PËR SHKOLLËN “EDIT DURHAM”

Kompania Marlotex shpk, e sipërmarrësit shqiptar në Francë Gazmend Toska, nën organizimin e Dhomës së Biznesit të Diasporës Shqiptare dhe me mbështetjen e ministrit të Shtetit për Diasporën, z.Pandeli Majko dhe Ministrisë së Arsimit ,Sportit dhe Rinisë, dhuroi ditën e sotme 720 maska tekstile për shkollën “Edit Durham” në Tiranë. Kjo iniciativë vjen si një mbështetje e sipërmarërsve shqiptarë të Diasporës për të kontribuar në shkëputjen e zinxhirit **Covid-19**.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



“DASH” PËR BANKAT NË SHQIPËRI – TË MIRËKAPITALIZUARA DHE TË QENDRUESHME

Në raportin e përditësuar të klimës së investimeve në vendin tonë, Departamenti Amerikan i Shtetit (DASH) merr në analizë gjerësisht edhe sektorin bankar në vendin tonë. Në raport thuhet se, sistemi bankar në vend është i mirëkapitalizuar, i qëndrueshëm dhe likuid. Norma e lartë e kredive jo performuese ka qenë një problem më parë, por se tashmë i ka hyrë trendit rënës, thotë më tej Departamenti Amerikan i Shtetit. Ndër të tjera, raporti thotë se, shumica e bankave që operojnë në vendin tonë janë degë të bankave të huaja, me vetëm 3 banka që kanë pronësi shqiptare, ku nënvizon edhe faktin se bankat shqiptare kanë rritur prezencën në treg gjatë viteve të fundit si rrjedhojë e procesit të konsolidimit të sektorit.

PËR MË SHUMË KLIKONI KËTU: >>>>



JAVA NË LAJME :

FILANTROPI LAZIM DESTANI FINANCON
REHABILITIMIN E KLINIKËS KIRURGJIKALE NË SHKUP



“TIRANA VJEN TEK TI”/ MUZEU I LËVIZSHËM
ÇON KRYEQYTETIN NË TREVAT SHQIPFOLËS



FINLANDË/ MËSUESIT MARRIN TEKSTET MËSIMORE
DËRGUAR FALAS NGA QBD



SHBA/ ZHVILLOHET SEMINARI “PERSPEKTIVA
TË MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË DIASPORË”



KURSI I KËMBIMIT

MONEDHA	BLERJE	SHITJE
USD	105	105. ⁷⁰
EUR	123. ⁸⁰	124. ³⁰
CHF	114. ⁹⁰	115. ⁷⁰
GBP	135	136. ³⁰
DKK	16. ³²	16. ⁷²